



"Prag"

Pjesë sociale e dramatizuar, kushtuar sfidës së grave të dhunuara shqiptare, në kërkim të identitetit të tyre, me ndihmën e Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare.

Përgatiti: Ben Andoni
Udhëheqëse Artistike: Aneta Malaj

Pjesa social-teatrale "Prag" po shfaqet me sukses në disa njësi vendore të vendit. Këto aktivitete organizohen nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare në kuadrin e zbatimit të projektit "Forcimi i grave në nevojë dhe rritja e ndërgjegjësimit të komunitetit në adresimin e diskriminimit gjinor dhe dhunës në familje përmes dramatizimit dhe performancës", i cili mbështetet nga *Civil Rights Defenders*, partner në projekt. "Prag" do të shfaqet në rrethet Tiranë, Lezhë dhe Vlorë.

Në datën 15 Dhjetor 2014 u zhvilluan dy aktivitete në ambientet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve në Lezhë, përkatësisht në orën 10:00 dhe 12:00. Në këto aktivitete, morën pjesë rreth 117 të ftuar, nxënës, mësues e prindër, të cilët ndoqën shfaqjen me mjaft interes dhe në përfundim të saj zhvilluan diskutime aktive mbi çështjet që trajtoheshin në këtë pjesë.

Në vijim, do të organizohen aktivitete të ngjashme në datën 18 Dhjetor, në ambientet e Bashkisë Vlorë, me komunitetin dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme.



Foto nga shfaqja "Prag", në ambientet e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, në Lezhë